VENDIM
Nr. 337, datë 6.6.2018

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR SEZONIN E VERËS 2018, NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA, PRANË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18, pika 2, dhe 18/1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 500 (pesëqind) punonjësve me kontratë të përkohshme për sezonin e verës 2018 në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vendet e punës të përcaktuara në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Detajimi i numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme sipas emërtesës së vendit të punës bëhet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

2. Periudha kohore e veprimtarisë sezonale, që do të kryejnë punonjësit me kontratë të përkohshme, është 2 muaj, korrik - gusht 2018.

3. Punonjësit me kontratë të përkohshme përfitojnë pagën bazë minimale, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Fondi i pagave për numrin e punonjësve të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018, në shumën 35 010 000 (tridhjetë e pesë milionë e dhjetë mijë) lekë, i cili i akordohet programit buxhetor "Zhvillimi i turizmit", me kod 04760.

5. Efektet financiare do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës së përkohshme, ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në cilësinë e punëdhënësit, dhe punëmarrësit.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Nr.	Lloji i aktivitetit	Emërtesa e vendit	Gjendja
1	Pikat kufitare	Pika kufitare e Morinës (Kosova)	Për t'u ngritur
2		Pika kufitare e Murriqanit (Mali i Zi)	Për t'u ngritur
3		Porti i Durrësit (Itali, BE)	Për t'u ngritur
4		Aeroporti i Tiranës (të gjitha drejtimet)	Për t'u ngritur
5		Pika kufitare e Qafëthanës (Maqedoni)	Për t'u ngritur
6		Porti i Vlorës (Itali, BE)	Për t'u ngritur
7		Pika kufitare e Kapshticës (Greqi)	Për t'u ngritur
8		Pika kufitare e Kakavijës (Greqi)	Për t'u ngritur
9		Porti i Sarandës (Greqi)	Për t'u ngritur
		TOTALI	
1		Plazhi i Velipojës	Për t'u ngritur
2		Plazhi i Shëngjinit	Për t'u ngritur
3		Gjiri i Durrësit (disa pika)	Për t'u ngritur
4		Lungomare e Vlorës	Për t'u ngritur
5	*Info point*/plazhe	Zona e Orikum-it (qendra e Rradhimës)	Ekzistuese
6		Llogora (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
7		Plazhi i Dhërmiut	Për t'u ngritur
8		Plazhi/qytetit i Himarës e zonat përreth	Për t'u ngritur
9		Zona e Ksamilit	Për t'u ngritur
10	*Info point*/	Qyteti i Shkodrës	Për t'u ngritur
11	qendra vizitorësh	Parku i Thethit (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
12		Parku i Valbonës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
13		Qyteti i Beratit	Për t'u ngritur
14		Qyteti i Pogradecit	Për t'u ngritur
15		Qyteti i Përmetit (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
16		Qyteti i Gjirokastrës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
17		Qyteti i Korçës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
		TOTALI	